



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM
Nr. 12 datë 26.2.2020**

**"PËR MIRATIMIN NË PARIM TË BASHKËFINANCIMIT PËR PËRSHTATJEN
PËR STREHIM SOCIAL TË OBJEKTEVE EKZISTUESE NË ZBATIM TË
FONDEVE TË PLANIFIKUARA PËR PROGRAMET E STREHIMIT PËR VITIN
2020"**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 26.2.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, nenit 24 pika 2, neni 29 pika 1, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; të nenit 65 të Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", të nenit 4, pika 1 e nenit 40 të ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social", të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.458 datë 03.07.2019 "Për procedurën e kthimit në fond banese, me qëllim strehimi, të objekteve pronë shtetërore, që përshtaten nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me grante konkurruese nga buxheti i shtetit", pika 7 e Udhëzimit të Ministrit nr. 31, datë 18.11.2019 "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret e përfitimit të fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, VKB nr. 26 datë 30.12.2019 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2020 dhe të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar të bashkisë Shkodër për vitin 2020-2022", shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2060, datë 30.01.2020 "Mbi fondet për strehimin për vitin 2020", dhe relacionit të paraqitur nga administrata e Bashkisë Shkodër, me 38 vota pro,

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të bashkëfinancimit për përshtatjen për strehim social të objektit ekzistues "ish konvikti i shkollës Veterinare".
2. Përqindja e bashkëfinancimit do të jetë deri në 20% të vlerës së rikonstruksionit, e përkthyer kjo në një vlerë deri në 20,000,000 lekë.
3. Burimi financimit do të jetë nga Programi 03280 "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile", zëri "Transferime", në kërkesën buxhetore P03280.O1.A1."Struktura e

mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër",
aktiviteti "Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile".

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

Sekretar i Këshillit



Denis Lasha

KRYETARE

